



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 134

Tiranë – E hënë, 19 qershor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 26.5.2017	të Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 25, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	6789
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 26.5.2017	të Mbi miratimin e disa ndryshimeve në vendimet e bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, dhe nr. 61, datë 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.....	6790
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 26.5.2017	të Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror.....	6791
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 26.5.2017	të Mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror.....	6800
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 26.5.2017	të Për licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6807
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 26.5.2017	të Mbi licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	6808



VENDIM

Nr. 75, datë 26.5.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 25, DATË 15.2.2017, “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 169, DATË 31.10.2016, “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103, DATË 23.6.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK””

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, germa “P”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 25, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19, germa “P”, ERE miraton me propozim të të licencuarve rregullat për: 1) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- OSHEE sh.a. ka kërkuar me shkresën nr. 12136 Prot., datë 15.5.2017, shtyrjen e afatit të hyrjes

në fuqi të rregullores së miratuar me vendimin nr. 103, datë 23.6.2016, të bordit të ERE-s.

- OSHEE sh.a. bën me dije se grupi i punës i ngritur nga OSHEE ka filluar punën me qëllim krijimin e platformës *online* për prokurim/blerjen *online* të energjisë elektrike dhe është hapur procedura me objekt “ndërtimin e platformës elektronike të publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike”.

- OSHEE sqaron se, duke marrë parasysh afatet ligjore që parashikon ligji i prokurimit publik, “... autoriteti kontraktor fton operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën jo më vonë se 60 ditë nga data e publikimit”, si dhe të depozitojë dokumentet standarde të tenderit, ku kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor i ekzekutimit është 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.”

- ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 25, datë 15.2.2017, si më poshtë:

- “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin nr. 103, datë 23.6.2016, të bordit të ERE-s, hyn në fuqi brenda datës 31.7.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 76, datë 26.5.2017

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E BORDIT TË ERE-S NR. 140, DATË 22.11.2013, DHE NR. 61, DATË 7.7.2014, “MBI RREGULLAT PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, në lidhje me “Miratimin e disa ndryshimeve në vendimet e bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, dhe nr. 61, datë 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”,

konstatoi se:

- Neni 65 i ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon që Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, e cila miratohet nga ERE.

- Bordi i ERE-s me vendim nr. 5, datë 19.1.2017, filloi procedurën “Për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013, dhe nr. 61, datë 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

- ERE, me shkresën nr. 87 Prot., në datën 26.1.2017, dërgoi ndryshimet mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, për marrje mendimi, pranë subjekteve: KESH sh.a, OSHEE sh.a, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Autoriteti i Konkurrencës, AEES.

- Pas përfundimit të afatit të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara rezultoi se në ERE janë paraqitur komente nga Autoriteti i Konkurrencës.

- Pas fillimit të procedurës për miratimin e ndryshimeve të propozuara, shoqata AAES ka përcjellë për dijeni në ERE korrespondencën e saj me OST-në në lidhje me disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013, dhe nr. 61,

datë 7.7.2014, “Mbi rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”. Me shkresën me nr. 1 Prot, datë 16.1.2017, shoqata AAES ka parashtruar disa ndryshime. Me shkresën me nr. 242/1 Prot, datë 25.1.2017, shoqëria OST sh.a. ka parashtruar kundërshtitë e veta në lidhje me propozimet e shoqatës AAES.

- Korrespondenca sa më sipër mes palëve nuk ka objekt të saj shqyrtimin apo diskutimin mbi propozimet për të cilat bordi i ERE-s ka filluar procedurën. Bazuar në nenin 65 të ligjit 43/2015, Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, e cila miratohet nga ERE.

- OST-ja nuk rezulton të ketë propozuar ndryshime të tjera në këtë rregullore përtej atyre për të cilat bordi i ERE-s ka filluar procedurën me vendimin nr. 5, datë 19.1.2017.

- Ndryshimet e propozuara nga AEES janë objekt shqyrtimi në momentin e kërkimit të këtyre ndryshimeve nga OST-ja ose me iniciativën e ERE-s.

- Në datë 18.5.2017 u zhvillua një seancë dëgjimore me përfaqësues të AK-së dhe OST-së dhe u dakordësua nga OST sh.a. propozimi i Autoritetit të Konkurrencës për ndryshime në rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, për të cilat ka filluar procedura.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në vendimet e bordit të ERE-s nr. 140, datë 22.11.2013, dhe nr. 61, datë 7.7.2014, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”, si më poshtë:

a) Në pikën 5.1, “Alokimin ditor” (miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013, të ERE-s), termi “D+2” të zëvendësohet me termin “D+1” në të gjithë përmbajtjen e tij.

b) Në pikën 5.1, “Ankandi ditor” (miratuar me vendimin nr. 61, datë 7.7.2014, të ERE-s) bëhet: “Procedura e alokimit ditorë do të realizohet çdo ditë të javës”.

c) Në pikën 5.3, “Mekanizmi i zhvillimit të ankandeve” (miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013, të ERE-s), bëhet: “Në rast se për kapacitetin e mbetur ka dy ose më shumë oferta më çmim të njëjtë, atëherë do të refuzohet më parë oferta që ka sasinë më të ulët”.



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 77, datë 26.5.2017

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR

Në mbështetje të neneve 16, pika 7 dhe 47 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi draftin dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e “Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror” (RCP),

konstatoi:

1. Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, në nenin 47 përcakton se:

a) OST-ja krijon një program të përputhshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputhshmërisë me këtë program. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputhshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputhshmërisë.

b) Zyrtari i përputhshmërisë emërohet nga këshilli mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE. ERE mund të refuzojë miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Zyrtari i përputhshmërisë mund të jetë një person fizik ose

juridik, i pavarur në punën dhe veprimet e tij ose të saj.

c) ERE miraton kriteret dhe detyrat për pozicionin e zyrtarit të përputhshmërisë, si dhe afatin e qëndrimit në detyrë. Këto kriteret kanë qëllim të sigurojnë pavarësinë e zyrtarit të përputhshmërisë dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij.

2. Enti Rregullator i Energjisë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 27, datë 15.2.2017, vendosi fillimin e procedurave “Për miratimin e Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror” (RCP).

3. Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave cituar më lart, Enti Rregullator i Energjisë vijoi me procesin e konsultimit të draftrregullores me palët e interesuara, të cilat kanë paraqitur opinion në ERE si më poshtë:

a) Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 81/1, datë 21.3.2017, protokolluar me tonën nr. 181/1, datë 24.3.2017, shprehet:

“Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 21.3.2017 mori në shqyrtim projektprogramin dhe shprehet se: Nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 21.3.2017, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”.

b) Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në datën 10.3.2017, në kontakt në postën zyrtare të ERE-s erealb@ere.gov.al, shprehet se:

“Nuk ka ndonjë vërejtje në lidhje me hartimin e Programit të përputhshmërisë të OST-së për gazin natyror. Sekretariati i Energjisë shpreh dakordësinë e tij për të vazhduar më tutje”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Programit të përputhshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror (RCP), bashkëlidhur.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



PROGRAMI I PËRPUTHSHMËRISË I OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR

[emri i OST-së]

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Program përputhshmërie (këtu dhe më poshtë Programi) i Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror (këtu dhe më poshtë OST) vendos kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OST-së sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe ka për qëllim të përcaktojë masat që duhet të ndërmerren për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese në aktivitetet e OST-së, si dhe të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të OST-së për të përmbushur objektivat e përcaktuara në këtë dokument dhe kërkesat për zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi.

2. Ky Program ka si qëllim të sigurojë:

2.1 Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST-së;

2.2 Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror (këtu dhe më poshtë pjesëmarrësit) dhe përdoruesve të rrjetit;

2.3 Parandalimin e aksesit të kushtet koncesionare në sistemin e transmetimit, të cilat duhet të ofrohen për pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit;

2.4 Prezantimi i një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST-së në lidhje me këtë; dhe

2.5 Prezantimi i një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

3. Të gjithë termat e këtij Programi duhet të përdoren në kuptimin e përkthuar në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

II. STATUSI LIGJOR DHE STRUKTURA E KORPORATËS SË OST-SË

4. [Ju lutem përshkruani formën ligjore dhe statusin e kompanisë OST.]

5. [Ju lutem shpjegoni strukturën e aksioneve të kompanisë OST, duke përfshirë marrëdhënien e aksionarëve të OST-së me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, ose ato që kanë ndonjë interes komercial.]

6. [Ju lutem shpjegoni ndarjen dhe pavarësinë e organeve publike të cilat janë të autorizuara të

përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe të kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër.]

7. [Ju lutem përshkruani, nëse është e arsyeshme, filialet e OST-së dhe/ose kompanive të tjera ku OST-ja është aksioner ose zotëron ndonjë interes komercial.]

8. [Ju lutem përshkruani strukturën e korporatës së OST-së, duke përfshirë organet përgjegjëse, statusin e tyre ligjor, parimet e përgjithshme të formimit të tyre, parimet qeverisëse të korporatës etj.]

9. [Ju lutem jepni çdo informacion të përshatshëm. Nëse është e nevojshme, struktura organizative dhe/ose ajo e korporatës mund t'i bashkëngjitet si shtojcë këtij Programi.]

III. NDARJA DHE PAVARËSIA E OST-SË

A. Ndarja e OST-së

10. OST-ja duhet të ndahet nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

11. OST-ja duhet të jetë një person juridik i ndarë, që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës së korporatës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike.

12. Për të siguruar ndarjen e duhur të OST-së, i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtë që njëkohësisht:

12.1 të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

12.2 të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

12.3 të emërojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të



Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike; dhe

12.4 të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

13. Të drejtat, të cilat referohen në paragrafin 3, përfshijnë veçanërisht:

13.1 kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

13.2 kompetencën për të emëruar anëtarët e bordit mbikëqyrës, bordit administrativ ose organeve ligjore që përfaqësojnë kompaninë;

13.3 të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

14. OST-ja mund të funksionojë si një operator i kombinuar sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në nenin 80 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Në çdo rast, statusi i OST-së si operator i kombinuar nuk do të ketë efekt në kërkesat për ndarjen dhe pavarësinë e OST-së të krijuar sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe këtij Programi. Masat që do të ndërmerren për të përjashtuar sjelljen diskriminuese në lidhje me aktivitetet e tjera të Operatorit të Kombinuar, që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror, duhet të vendosen në një dokument tjetër përputhshmërie të hartuar sipas kërkesave të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

B. Pavarësia drejtuese e OST-së

15. Drejtuesit e OST-së, të tillë si anëtarët e bordit mbikëqyrës, anëtarët e bordit drejtues, menaxheri i përgjithshëm, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njërive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

15.1 Drejtuesit e OST-së nuk duhet të punësohen ose të lidhen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të këtyre;

15.2 Pagat e drejtuesve të OST-së duhet të

vendosen në bazë të elementeve të paracaktuara që kanë lidhje me performancën e OST-së, si specifikohet te kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit;

15.3 Drejtuesit e OST-së nuk kanë interes ose marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, me përjashtim të të drejtave të tyre aksionare financiare sipas paragrafit 15.6;

15.4 Transferimi i drejtuesve të OST-së te kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, duhet të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë te statutet e OST-së dhe duhet të ndiqen rregullisht, dhe asnjë nga këto transfera nuk duhet të paracaktohet që në fillim;

15.5 OST-ja nuk duhet të ketë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre; dhe

15.6 Drejtuesit e OST-së nuk duhet të kenë më shumë se 1/5 e aksioneve të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, dhe duhet të shmangin konfliktet e mundshme të interesit që kanë lidhje me këto aksione.

C. Pavarësia funksionale dhe vendimmarrëse e OST-së

16. OST-ja duhet të funksionojë si Operator i Sistemit të Transmetimit për gazin natyror sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

17. Midis të tjerave, OST-ja duhet të jetë përgjegjëse për dhënien dhe aksesin e palës së tretë, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve.

18. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, OST-ja duhet të jetë përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re.

19. OST-ja duhet të jetë e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe akteve të tjera



ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë ERE).

20. OST-ja duhet të mirëmbajë në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror në përputhje me kërkesat për pavarësinë e tij, të vendosura në paragrafët 16-19 të këtij Programi.

21. Asnjë nga aktivitetet funksionale të OST-së dhe/ose të drejtat vendimmarrëse nuk mund të ndikohet nga interesat komerciale dhe interesa të tjera të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre.

IV. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE

A. Aksesi në sistemin e transmetimit

22. OST-ja duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të cilët përputhen me kërkesat e vendosura te ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

23. OST-ja mund të refuzojë dhënien e aksesit në sistemin e transmetimit vetëm në bazë dhe rastet e përcaktuara te ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

24. Dhënia e aksesit në sistemin e transmetimit ose refuzimin për të dhënë një akses të tillë, si dhe dispozitat për shërbimet e OST-së nuk duhet të përfundojë në një trajtim preferencial të pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit ose, në të kundërt, nuk duhet të jetë diskriminuese ndaj këtyre pjesëmarrësve të veçantë ose përdoruesve të rrjetit.

25. Punonjësit e OST-së duhet të merren me kërkesën për shërbimet e OST-së të marra nga pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese, duke mos favorizuar pjesëmarrësit ose përdoruesit e veçantë të rrjetit, që mund të sjellë një avantazh të padrejtë komercial.

26. Paragrafët 24 dhe 25 duhet të zbatohen për prokurimin dhe shitjen e shërbimeve, për çmimin, aksesin ndaj shërbimeve ekskluzive dhe shërbimeve të konsumatorit, duke përfshirë

gatishmërinë për ofrimin e shërbimeve të veçanta dhe efikasitetin e tyre.

27. Tarifat dhe detyrimet e tjera për shërbimet e OST-së duhet të rregullohen sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe duhet të publikohen në faqen e OST-së dhe të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit që përmbushin kriteret përkatëse të vendosura në aktet ligjore në fuqi dhe te Kodi i Rrjetit të Transmetimit.

B. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

28. Aktivitetet e OST-së nuk duhet të kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror.

29. Çdo transaksion komercial dhe financiar nga OST-ja, përfshirë huatë, kreditë dhe marrëveshjet e tjera financiare, si dhe transaksionet me kompanitë që kanë lidhje, duhet të organizohen sipas kushteve të tregut dhe në asnjë rast ato nuk duhet të ndikojnë negativisht në pavarësinë e OST-së.

30. OST-ja duhet të njoftojë ERE-n për transaksionet e mbyllura komerciale dhe financiare duke iu referuar paragrafit 29 dhe me kërkesën e ERE-s duhet të ofrojnë kopje të këtyre transaksioneve dhe dokumenteve origjinale, ofertave komerciale, deklaratave të pranimit, memorandume, fatura etj.

31. Kopje të të gjitha kontratave të mbyllura nga OST-ja me pjesëmarrësit e tjerë, përdoruesit e rrjetit dhe/ose palëve të tjera të treta dhe dokumente të tjera origjinale (oferta komerciale, deklarata pranimi, memorandume, fatura etj.) duhet të ruhen dhe arkivohen me kujdes te zyrtarët e OST-së dhe duhet të vendosen në dispozicion të Zyrtarit të Përputhshmërisë të kompanisë OST (këtu dhe më poshtë Zyrtari i Përputhshmërisë).

C. Konflikti i interesit

32. Në rastin e një konflikti ekzistues të interesit ose konflikti të mundshëm, drejtuesi ose punonjësi i OST-së duhet të informojë në kohë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zyrtarin e Përputhshmërisë të kompanisë OST, por jo më vonë se dita tjetër e punës, pasi ai/ajo është vënë në dijeni për konfliktin ekzistues të interesit ose ndonjë rrethanë që mund të shkaktojë një konflikt interesi.



33. Konflikti i interesit nënkupton çdo situatë kur ka ndodhur një interes personal i drejtuesit ose punonjësit të OST-së, qoftë ky konflikt direkt përmes personave që kanë lidhje, ose një konflikt i papërputhshëm me veçimin, pavarësinë, sjelljet e tregut dhe/ose veprimtaritë funksionale të kompanisë OST, ose konflikt në të cilin drejtuesi ose punonjësi i OST-së është ose mund të jetë në pozicionin për të përfituar nga veprimet ose vendimet e marra si drejtues ose punonjës i OST-së.

34. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas njoftimit për konfliktin e interesit, drejtuesi ose punonjësi në fjalë i OST-së duhet të konsultohet me Drejtuesin e Përgjithshëm ose Zyrtarin e Përputhshmërisë të kompanisë OST, për të shmangur ose eliminuar konfliktin e interesit, ose për të përfunduar marrëdhëniet e punës ose ato profesionale me OST-në në rast dështimi ose mosdashjes së menaxherit, ose punonjësit për të zgjidhur konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit.

35. Të gjitha kontratat e punësimit midis OST-së dhe drejtuesve ose punonjësve, si dhe udhëzimeve profesionale për drejtuesit e emëruar duhet të ofrojnë mundësinë e përfundimit të kontratave të punës ose shkarkimin nga detyra të drejtuesit sipas lirisë së veprimit të kompanisë OST, në rast se nuk mund të ndalohej ose zgjidhet konflikti i interesit ose mosdashjes së drejtuesit, ose punonjësit që të zgjidhin konfliktin ekzistues, ose konfliktin e mundshëm të interesit.

V. POLITIKA E INFORMACIONIT TË KOMPANISË OST

A. Sigurimi i informacionit

36. OST-ja duhet të sigurojë informacionin funksional dhe informacionin përkatës të sistemit të transmetimit dhe shërbimeve të saj, i cili nuk mbrohet si informacion i ndjeshëm tregtar sipas kushteve dhe termave të akteve ligjore në fuqi dhe këtij Programi. Sigurimi i informacionit duhet të kryhet në mënyrë të drejtë, transparente, dhe jodiskriminuese. OST-ja duhet të ndalojë sigurimin e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, mund të sjellë avantazhe konkurruese për pjesëmarrësit e veçantë ose përdoruesit e rrjetit. Informacioni publik duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së, si kërkohet nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe akteve ligjore në fuqi.

37. OST-ja duhet t’i sigurojë informacion të mjaftueshëm operatorëve të tjerë të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, operatorëve të sistemit të depozitimit dhe operatorëve të sistemit të GNL-së për të siguruar rrjedhje të sigurt dhe eficiente të gazit natyror midis sistemeve të ndërlidhura të gazit natyror. Ky informacion duhet të sigurohet sipas termave dhe kushteve të përcaktuara të ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, akteve ligjore në fuqi dhe kodeve të rrjetit.

38. OST-ja duhet t’u sigurojë pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pakufizuar të sistemi i transmetimit. Ky informacion duhet të sigurohet në mënyrë jodiskriminuese sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

B. Konfidencialiteti i informacionit

39. OST-ja duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë nga OST-ja gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale, dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të matura për të shmangur informacionin e ndjeshëm tregtar në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregtare për persona të tjerë nga shpërndarja diskriminuese.

40. Për qëllime të cilave iu jemi referuar në paragrafin 39, informacioni i ndjeshëm tregtar nënkupton:

40.1 Informacioni në lidhje me menaxhimin, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit përveç informacionit publik, i përkufizuar si i tillë sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe këtij Programi;

40.2 Informacioni që përmban sekrete tregtare dhe informacione të tjera të ndjeshme tregtare të marra nga OST-ja në mënyrë që të kryejë aktivitetet e tij;

40.3 Informacione të tjera të natyrës tregtare, financiare ose teknike, të cilat u vijnë drejtuesve ose punonjësve të OST-së gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional, që janë informacione të ndjeshme tregtare dhe mund të merren nga pjesëmarrës të ndryshëm, ofrohet si një avantazh konkurrues në tregun e gazit natyror; dhe



40.4 Informacioni i klasifikuar si konfidencial ose në konfidencialitet dhe/ose marrëveshjet e fshehta të firmosura nga OST-ja.

41. OST-ja nuk duhet të shpërndajë informacionin e ndjeshëm tregtar tek ndonjë palë e tretë, përveç rasteve kur:

41.1 Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj;

41.2 Një pëlqim paraprak me shkrim për shpërndarjen e informacionit jepet nga personi ndaj të cilit OST-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit; ose

41.3 Kur informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes së ligjshme publike të tij.

42. Në rast shpërndarje të informacionit të ndjeshëm tregtar nga OST-ja për ndonjë palë të tretë sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 41, kjo shpërndarje duhet të kryhet në masën e nevojshme që OST-ja të sigurojë shërbimet e saj dhe duhet të jetë në përputhje me konfidencialitetin dhe/ose marrëveshjen për të mos e shpërndarë, e cila vendos detyrimin e palës së tretë për informacionin konfidencial të marrë nga OST-ja, si dhe vendosjen e detyrimeve financiare për këtë palë të tretë në rast të moskryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të detyrimeve konfidenciale.

43. OST-ja duhet të ruajë informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe/ose shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga OST-ja, duhet të mbajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion dhe nuk e shpërndajnë atë tek ndonjë palë e tretë, përveç se kur specifikohet ndryshe në kontratë. Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve kontraktuale dhe pas mbarimit të tyre derisa informacioni konfidencial të shpërndahet publikisht në mënyrë ligjore.

44. Drejtuesit ose punonjësit e OST-së duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të cilin e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Veçanërisht për të siguruar konfidencialitetin e informacionit

të ndjeshëm tregtar, drejtuesit dhe punonjësit e OST-së:

44.1 Nuk duhet t'i lënë materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregtar siç janë (dokumentet, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, tableta, telefonat etj.) të pambrojtur në vende publike;

44.2 Nuk duhet ta diskutojnë informacionin e ndjeshëm tregtar në publik; dhe

44.3 Kur përdorin postën elektronike ose aplikimet e tjera të komunikimit *online*, me shumë kujdes duhet të kontrollojnë përmbajtjen e mesazhit dhe adresat e marrësit për të shmangur shpërndarjen e mundshme të informacionit të ndjeshëm tregtar tek ndonjë palë e tretë.

45. Çdo dokument me shkrim i OST-së që përmban informacion të ndjeshëm tregtar duhet të shënohet si i tillë në faqen e parë.

46. Të drejtat e aksesit të sistemet e informacionit dhe databazat e OST-së, si dhe të drejtat e aksesit të disqet dhe dosjet e përbashkëta duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos favorizojnë pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit. Për këtë arsye, transaksionet *online* ose aksionet që përbëjnë rrezik për shpërndarjen e informacionit të ndjeshëm tregtar duhet të tregohen qartë dhe duhet të mbahet një listë për autorizimet e aksesit nga Zyrtari i Përputhshmërisë, dhe duhet të përditësohet çdo vit ose më shpesh nëse është e nevojshme.

47. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët nuk duhet të shpërndajnë informacionin e ndjeshëm tregtar tek ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me OST-në dhe të paktën 3 (tre) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, bashkëpunimit deri kur:

47.1 Pëlqimi paraprak për shpërndarjen të jepet nga personi të cilit OST-ja ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e informacionit;

47.2 Informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes ligjore publike të tij; ose

47.3 Shpërndarja e informacionit kërkohet nga ligji në fuqi.

48. Në rast shpërndarje sipas paragrafit 47, drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e tyre të autorizuar, audituesit dhe këshilltarët janë të detyruar të sigurojnë që informacioni i



ndjeshëm tregtar është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit në të njëjtën kohë për të mos i dhënë asnjë personi një avantazh të padrejtë tregtar në tregun e gazit natyror.

49. Në përputhje me kërkesat e transparencës të kompanisë OST, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jodiskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST-së. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të OST-së.

50. Marrëveshjet konfidenciale me drejtuesit e emëruar të OST-së, kontratat e punësimit me punonjësit e OST-së, si dhe marrëveshjet e mbyllura midis OST-së dhe përfaqësuesve të saj të autorizuar, audituesve dhe këshilltarëve duhet t'u ofrojnë drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar, audituesve dhe këshilltarëve detyrimet që kanë lidhje me konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar dhe duhet të vendosin detyrimet financiare në rast të moskryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të këtyre detyrimeve.

51. Çdo prishje e detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, si kërkohet sipas këtij Programi dhe kontratave respektive, mund të quhet shkelje e madhe e detyrimeve të drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar, audituesve ose këshilltarëve, dhe mund t'i japë OST-së të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit.

C. Informacioni publik

52. Informacioni publik nënkupton çdo informacion që përgjithësisht njihet se ka një karakter publik ose çdo informacion tek i cili aplikohen kërkesat për shpërndarjen e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi. Ky informacion nuk mund të klasifikohet si konfidencial ose informacion i ndjeshëm tregtar dhe duhet të vendoset në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të tjera të treta.

53. OST-ja duhet të publikojë në faqen e internetit informacionin e mëposhtëm:

53.1 Listën e shërbimeve të ofruara nga OST-ja, informacion për tarifën dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe lidhjen me sistemin e transmetimit;

53.2 Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të transmetimit për pikat hyrëse dhe dalje dhe metodologjinë për përcaktimin e tarifës së lidhjes për lidhjen me sistemin e transmetimit;

53.3 Informacionet shifrore për vëllimet e kapacitetit teknik, kapacitetit të kontraktuar dhe kapacitetit në dispozicion të sistemit të transmetimit në lidhje me pikat hyrëse dhe dalje në bazë mujore;

53.4 Të dhëna për vëllimet e planifikuara dhe ato aktuale të gazit natyror që do të transportohet nëpërmjet sistemit të transmetimit; dhe

53.5 Informacione të tjera të specifikuar në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

54. OST-ja duhet të arkivojë informacionin të cilit i jemi referuar në paragrafin 53 për 5 (pesë) vjet nga data kur ai është vendosur dhe duhet ta rinxjerrë atë me kërkesën e autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

VI. ZBATIMI I PROGRAMIT

A. Karakteri detyrues i Programit

55. Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit dhe në rastet referuar këtij Programi dhe kontratave të mbyllura nga OST-ja ose tek aktet ligjore në fuqi, zbatimi i dispozitave të caktuara të këtij Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OST-së, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, si dhe palët e tjera të treta.

56. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Në rast ndryshimesh ose amendimesh të Programit, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur drejtuesit e OST-së, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët për përmbajtjen e këtyre ndryshimeve ose amendimeve dhe drejtuesit



përkatës, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që ata janë njoftuar në kohë për këto ndryshime dhe amendime të Programit.

57. Të gjithë drejtuesit e OST-së dhe punonjësit duhet të udhëzohen rregullisht për zbatimin e këtij (të paktën një herë në vit). Drejtuesit e rinj dhe punonjësit duhet të udhëzohen para se të fillojnë mandatin e tyre ose para se të punësohen. Udhëzimet duhet të jepen nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

58. Nëse drejtuesit ose punonjësit e OST-së vihen në dijeni për shkeljen e ndonjë dispozite të Programit, drejtuesi ose punonjësi duhet të informojë menjëherë Zyrtarin e Përputhshmërisë.

59. Shkelja e ndonjë dispozite të Programit mund të cilësohet si shkelje e detyrimeve nga drejtuesi, punonjësi, përfaqësuesi i autorizuar, audituesi ose këshilltari dhe mund t'i japë OST-së të drejtën për të zbatuar veprimet disiplinore sipas termave dhe kushteve të përcaktuara tek aktet ligjore në fuqi dhe kontratat respektive dhe/ose aktet e brendshme të kompanisë OST.

B. Monitorimi i zbatimit të Programit

60. Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin siç duhet të Programit duhet të kryhet nga Zyrtari i Përputhshmërisë, i cili duhet të funksionojë në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe kontratës së lidhur midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë.

61. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të emërohet nga [organi përgjegjës] i kompanisë OST, si specifikohet në paragrafin e nenit 47, ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, pas miratimit paraprak nga ERE. Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse duhet të vendosen nga [organi përgjegjës] i kompanisë OST dhe të miratohen nga ERE. Së bashku me kandidimin për Zyrtar Përputhshmërie, OST-ja duhet t'i ofrojë ERE-s detajet për pavarësinë dhe përputhjen e kandidatit me kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse.

62. Kontrata midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të përshijë kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe të këtij Programi, dhe duhet të nënshkruhet pas miratimit paraprak nga ERE. Për

këtë qëllim, OST-ja duhet t'i ofrojë ERE-s të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për të arsyetuar përputhshmërinë me kërkesat përkatëse.

63. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë kryerjes së detyrës së tij. Për këtë qëllim:

63.1 Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar, ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë edhe operatorin e kombinuar, sipas rastit);

63.2 Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë kryer asnjë detyrë tjetër profesionale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kryejë ndonjë funksion tjetër ose të marrë pjesë në biznese, ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar, ose me shumicën e aksioneve për një periudhë prej të paktën 3 (tre) vjet para emërimit si Zyrtar i Përputhshmërisë për kompaninë OST;

63.3 Pas mbarimit të marrëdhënieve kontraktuale me OST-në, Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kryejë ndonjë funksion ose të marrë pjesë në biznese, ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar, ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me ndonjë kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit) për një periudhë prej jo më pak se 4 (katër) vjet; dhe

63.4 Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, ose nga kompanitë që kanë lidhje me aktivitetin e gazit natyror, përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit).

64. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm, si dhe kushtet e duhura financiare dhe organizuese që të mundësojë, midis të tjerash, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë



bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e OST-së kur verifikon dhe siguron përputhshmërinë me këtë Program.

65. Pagesa e Zyrtarit të Përputhshmërisë nuk do të bazohet te vlerësimet e performancës nga drejtuesi i OST-së. Politikat për këtë pagesë duhet të përgatiten në mënyrë të qartë në kontratën midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë.

66. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses tek të dhënat e nevojshme dhe në zyrat e OST-së dhe tek gjithë informacioni që duhet për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses në zyrat e OST-së pa njoftimin paraprak.

67. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtuesve të OST-së dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikëqyrëse dhe drejtuese, të cilat janë të detyruara të informojnë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara dhe duhet të sigurojnë të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të marrë pjesë në të gjitha takimet të cilat adresojnë çështjet në vijim:

67.1 kushtet për aksesin në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet dhe shërbimet për të pasur akses në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, si dhe në lidhje me alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

67.2 projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e transmetimit dhe për të mirëmbajtur e zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkufitare të interkonjeksionit dhe lidhjet; dhe

67.3 blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin e balancimit.

68. Përveç të drejtave të përcaktuara në paragrafin 67, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtën të marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve korporative të OST-së, te takimet e drejtuesve ose punonjësve duke përfshirë edhe takimet funksionale. Drejtuesit përgjegjës dhe/ose punonjësit duhet të njoftojnë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara ose jo.

69. Për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi dhe përmbushjen e detyrave, Zyrtari i Përputhshmërisë veçanërisht duhet të jetë përgjegjës për:

69.1 monitorimin e zbatimit të këtij Programi;

69.2 përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e këtij Programi dhe dërgimin e tij në ERE;

69.3 raportimin në organet përgjegjëse korporative të OST-së dhe dhënien e rekomandimeve për këtë Program dhe zbatimin e tij;

69.4 investigimin dhe raportimin tek organet përgjegjëse korporative të OST-së për çfarëdo shkelje të pretenduar në lidhje me zbatimin e këtij Programi, dhe paraqitjen e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;

69.5 investigimin e konfliktit ekzistues ose të mundshëm të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, ofrimin e konsultimeve për të parandaluar konfliktet e mundshme të interesit dhe korrigjimin e konfliktit ekzistues të interesit, si dhe zgjidhjet që propozohen për masat e nevojshme korrigjuese;

69.6 njoftimi i ERE-s për shkeljet në lidhje me zbatimin e këtij Programi;

69.7 raportimi në ERE për marrëdhëniet tregtare dhe/ose financiare midis OST-së dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre;

69.8 paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST-së, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;

69.9 monitorimi i përputhshmërisë së OST-së me dispozitat e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe këtij Programi duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;

69.10 monitorimi i ndryshimeve legislative dhe rregullatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e këtij Programi;

69.11 ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;

69.12 përgjigja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST-së në lidhje me këtë Program;

69.13 udhëzimin e drejtuesve dhe punonjësve të OST-së për këtë Program, zbatimin e tij dhe, kur



është e përshtatshme, ndryshimet e tij të përcaktuara në paragrafin 57;

69.14 koordinim i komunikimit me ERE-n, autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit dhe ose palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi.

70. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të japë opinion në lidhje me ndonjë dokument të brendshëm ose veprim të OST-së në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore në fuqi, duke përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë dhe me këtë Program.

71. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të refuzojë udhëzimet ose kërkesën e OST-së, organeve korporative, të drejtuesve, punonjësve dhe ose ndonjë përfaqësuesi të cilat janë ose ka mundësi të jenë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

72. Zyrtari i Përputhshmërisë mund të shkarkohet nga [organi përgjegjës] i OST-së, si specifikohet në paragrafin 11, neni 47 i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, pas miratimit paraprak nga ERE.

C. Raportimi për zbatimin e Programit

73. Çdo vit, jo më vonë se data [31 mars], Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST-së me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST-së dhe të ERE-s.

74. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të dorëzojë një raport, të cilit i jemi referuar në paragrafin 73, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

75. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të raportojë rregullisht, me gojë ose me shkrim, tek organet përkatëse korporative të OST-së në lidhje me zbatimin e këtij Programi.

VII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

76. Ky program duhet të miratohet me vendimin e [organit përgjegjës] të kompanisë OST dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pas përshtatjes së tij, ky vendim duhet të dorëzohet në ERE-n për miratim. Ky Program duhet të hyjë në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

77. Çdo ndryshim i këtij Programi duhet të pranohet dhe të hyjë në fuqi si specifikohet në paragrafin 76.

VENDIM

Nr. 78, datë 26.5.2017

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 16, pika 7 dhe 47, pika 2 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe neneve 15 dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë,

konstatoi:

1. Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” në nenin 47, pika 2 përcakton se:

“47.2. Zyrtari i Përputhshmërisë emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE. ERE mund të refuzojë miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Zyrtari i Përputhshmërisë mund të jetë një person fizik ose juridik, i pavarur në punën dhe veprimet e tij ose të saj.

47.3. ERE miraton kriteret dhe detyrat për pozicionin e Zyrtarit të Përputhshmërisë, si dhe afatin e qëndrimit në detyrë. Këto kriteret kanë qëllim të sigurojnë pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij”.

2. Enti Rregullator i Energjisë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 26, datë 15.2.2017, vendosi fillimin e procedurave “Për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë”.

3. Mbas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave cituar më lart, Enti Rregullator i Energjisë vijoi me procesin e konsultimit të Draftkontratës me palët e interesuara të cilat kanë paraqitur opinion në ERE si më poshtë:

a) Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 82/1, datë 21.3.2017, protokolluar me tonën nr. 183/1, datë 24.3.2017, shprehet:



“Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 21.3.2017 mori në shqyrtim Projektkontratën dhe shprehet se: “Projektkontrata për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 21.3.2017, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”.

b) Gjithashtu, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në datën 10.3.2017, në kontakt në postën zyrtare të ERE-s erealb@ere.gov.al, shpreh se:

“Nuk ka ndonjë vërejtje në lidhje Draftkontratën për ofrimin e shërbimit të Zyrtarit të Përputhshmërisë. Sekretariati i Energjisë shpreh dakordësinë e tij për të vazhduar më tutje”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Nr. [●]

[●] [●] [2017], [Tiranë]

[*Emri i OST-së*], një kompani e ngritur në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër regjistrimi nr. [●], me zyra qendrore [●] (këtu dhe më poshtë – “OST”), e përfaqësuar rregullisht nga [Drejtori i Përgjithshëm] [●], që vepron [në bazë të një mandati/autorizimi], dhe

- {ALTERNATIVA A}¹ [*Emri i Zyrtarit të Përputhshmërisë*], një kompani e ngritur në

¹ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Duhet të plotësohet nëse është e domosdoshme që Zyrtari i Përputhshmërisë të jetë një person juridik. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

mënyrë të vlefshme dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër regjistrimi nr. [●], me zyra qendrore [●] (këtu dhe më poshtë – “Zyrtari i Përputhshmërisë”), e përfaqësuar rregullisht nga [Drejtori i Përgjithshëm] [●], që vepron [në bazë të një mandati/autorizimi];

- {ALTERNATIVA B}² [*Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Përputhshmërisë*], numri personal [●], adresa e banimit [●] (këtu dhe më poshtë – “Zyrtari i Përputhshmërisë”),

këtu dhe më poshtë në mënyrë të përmbledhur iu referohemi si “Palët” dhe secilit në mënyrë të veçantë si “Pala”, duke marrë parasysh:

- {ALTERNATIVA A}³ OST-ja do të autorizohet për transmetimin e gazit natyror dhe do të certifikohet si operator i veçuar i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

- {ALTERNATIVA B}⁴ OST-ja autorizohet për transmetimin e gazit natyror sipas licencës nr. [●] lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë – “ERE”), datë [●] dhe është certifikuar si operator i veçuar i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. [●] datë [●];

- OST-ja e caktoi Zyrtarin e Përputhshmërisë me miratimin e vendimit nr. [●] të [organeve përkatëse] të kompanisë OST, datë [●], dhe miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. [●], datë [●];

- Kandidimi i Zyrtarit të Përputhshmërisë është miratuar nga ERE sipas vendimit të bordit nr. [●], datë [●]; dhe

- Zyrtari i Përputhshmërisë është emëruar nga [organet përkatëse]⁵ të kompanisë OST bazuar në vendimin e saj nr. [●], datë [●],

kanë lidhur këtë Kontratë për ofrimin e

² Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Duhet të plotësohet nëse është e domosdoshme që Zyrtari i Përputhshmërisë të jetë një person fizik. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

³ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: A duhet të nënshkruhet Kontrata para autorizimit dhe certifikimit të OST-së. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

⁴ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: A duhet të nënshkruhet Kontrata pas autorizimit dhe certifikimit të OST-së. Ju lutem fshijeni nëse nuk është e përshtatshme.

⁵ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Ju lutem specifikoni referencat për organet e korporatës për OST-në, duke përfshirë kompetencat përkatëse, pasi të jetë bërë e ditur vendosja përfundimtare e korporatës për kompaninë OST.



shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë (këtu dhe më poshtë – “Kontrata”) sipas termave dhe kushteve të mëposhtme.

1. SUBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Nëpërmjet kësaj, Palët bien dakord që Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ofrojë shërbimet e tij për kompaninë OST duke vepruar brenda kompetencave dhe sipas mandatit të vendosur sipas ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” (këtu dhe më poshtë – “Ligji”), akteve të tjera ligjore në fuqi, Programit të Përputhshmërisë dhe kësaj Kontrate, ndërkohë që OST-ja duhet të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme për Zyrtarin e Përputhshmërisë që ai të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet e tij dhe duhet të paguajë për këto shërbime.

1.2 Programi i Përputhshmërisë duhet të bashkëlidhet në [shtojcën I] të kësaj Kontrate dhe duke nënshkruar këtë, Zyrtari i Përputhshmërisë konfirmon që ai i kupton dhe është dakord me dispozitat e Programit të Përputhshmërisë, natyrën e tij kufizuese, detyrimet dhe të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë, dhe efektet për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

1.3 Kjo Kontratë do të konsiderohet si kontratë tregtare për ofrimin e shërbimeve të mbyllura sipas termave dhe kushteve të vendosura në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të tjera ligjore në fuqi. Dispozitat e përgjithshme që rregullojnë marrëdhëniet civile dhe tregtare midis Palëve duhet të aplikohen në Kontratë pa dëmtuar zbatimin e kërkesave specifike të krijuara me ligj.

1.4 Në rastet kur Zyrtari i Përputhshmërisë punësohet nga OST-ja për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Kontrate, kontrata e punësimit midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të përputhet plotësisht me dispozitat e kësaj kontrate dhe nuk duhet të vendosë kufizime në statusin dhe/ose aktivitetet e Zyrtarit të Përputhshmërisë ose të vendosë përjashtime nga të drejtat dhe/ose detyrimet e palëve, si është rënë dakord në këtë dokument.⁶

2. KUALIFIKIMET DHE PAVARËSIA E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

2.1 Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të

përbushë kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse të vendosura nga OST-ja [organi përkatës] dhe miratohen nga ERE, dhe që janë zbatuar për përzgjedhjen e Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të plotësojë kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës. Kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse, të vendosura nga OST-ja [organi përkatës] dhe të miratuara nga ERE, duhet të bashkëngjiten në [shtojcën II] të kësaj Kontrate.

2.2 Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë ofrimit të shërbimeve për OST-në. Pavarësia e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të sigurohet për gjatë gjithë vlefshmërisë së Kontratës dhe me mbarimin e saj, si specifikohet këtu dhe më poshtë, me aplikimin e kërkesave të mëposhtme:

2.2.1 Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë edhe operatorin e kombinuar, sipas rastit);

2.2.1.1 gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës;

2.2.1.2 për një periudhë prej të paktën 3 (tre) vjet para përfundimit të Kontratës; dhe

2.2.1.3 me përfundimin e kësaj Kontrate, për një periudhë prej të paktën 4 (katër) vjetësh;

2.2.2 Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, ose nga kompanitë që kanë lidhje me aktivitetin e gazit natyror, përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit).

2.3 Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të refuzojë çdo udhëzim ose kërkesë të OST-së, organeve korporuese, të drejtuesve, punonjësve dhe/ose çdo përfaqësuesi tjetër që është ose mund të jetë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

2.4 Në rastet kur statusi i kërkuar i pavarësisë, kriteret minimale profesionale dhe/ose kriteret e

⁶ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Kjo dispozitë, duke iu referuar marrëdhënieve të mundshme të punësimit midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, mund të hiqet në rastin kur kjo kontratë mbyllet me një person juridik i cili ofron shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë.



tjera përzgjedhëse ndryshojnë gjatë vlefshmërisë së kësaj Kontrate, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të informojë në kohë, por jo më vonë se dita tjetër e punës pasi është vënë në dijeni për këtë ndryshim, Drejtuesin e Përgjithshëm të OST-së për ndryshimin dhe të ofrojë shpjegime me shkrim që arsyetojnë dokumentacionin dhe, kur është e nevojshme, të ofrojë zgjidhje për ta korigjuar.

2.5 Në rastin referuar në paragrafin 2.4, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të tërhiqet përkohësisht nga pozicioni i tij derisa [organi përkatës] i OST-së të marrë vendimin për bashkëpunim të mëtejshëm me Zyrtarin e Përputhshmërisë ose të aplikojë në ERE për miratimin e përjashtimit të Zyrtarit të Përputhshmërisë. Kur është e nevojshme, [organi përkatës] i OST-së mund të konsultohet me ERE-n para se të marrë vendimin.

2.6 Mosplotësimi nga Zyrtari i Përputhshmërisë i kërkesave për kualifikimin e tij dhe/ose pavarësinë specifikuar në pjesën 2 konsiderohet si shkelje e kësaj Kontrate.

3. SHËRBIMET E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

3.1 Zyrtari i Përputhshmërisë ka për detyrë monitorimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë dhe për raportimin e këtij zbatimi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligj dhe të Programi i Përputhshmërisë. Veçanërisht, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ofrojë shërbimet e mëposhtme:⁷

3.1.1 monitorim të vazhdueshëm për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;

3.1.2 përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat që do të merren për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë dhe dorëzimi i këtij raporti në ERE dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë brenda afateve të përcaktuara në Programin e Përputhshmërisë;

3.1.3 raportim i vazhdueshëm në organet përkatëse të kompanisë OST dhe nxjerrja e rekomandimeve për Programin e Përputhshmërisë dhe zbatimin e tij;

3.1.4 investigim dhe raportim tek organet përkatëse të OST-së për shkeljet e pretenduara në

lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë dhe paraqitjes së zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korigjuese;

3.1.5 investigim i konfliktit të mundshëm ose ekzistues të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST-së, ofrimi i konsultimeve në lidhje me parandalimin e konflikteve të mundshme ose korigjimin e konflikteve ekzistuese të interesit, si dhe ofrimin e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korigjuese;

3.1.6 të informojë ERE-n për shkeljet në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;

3.1.7 raportim në ERE për marrëdhëniet tregtare dhe/ose financiare midis OST-së dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre;

3.1.8 ndjekja e takimeve të organeve përkatëse të OST-së dhe, kur është e përshtatshme, konsultimi i pjesëmarrësve në takime për kërkesat e Programit të Përputhshmërisë, në rastet kur takimet trajtojnë çështjet e mëposhtme:

3.1.9.

3.1.9.1 kushtet për aksesin në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet dhe shërbimet për të pasur akses në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, si dhe në lidhje me alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

3.1.9.2 projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e transmetimit dhe për të mirëmbajtur e zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkuftare të interkonjeksionit dhe lidhjet; dhe

3.1.9.3 blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin e balancimit.

3.1.10 paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST-së, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;

3.1.11 aktivitetet; monitorimi i përputhshmërisë së OST-së me dispozitat e ligjit dhe Programit të Përputhshmërisë duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;

⁷ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Shërbimet (detyrimet) e Zyrtarit të Përputhshmërisë të përcaktuara në paragrafin 3.1 shkruhen në përputhje me draftin e Programit të Përputhshmërisë (drafti fillestar i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 7 dhjetor 2016). A duhet të ndryshohet Draftprogrami i Përputhshmërisë, ju lutem pasqyroni ndryshimet në këtë Draftkontratë.



3.1.12 monitorimi i ndryshimeve legislative dhe rregullatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;

3.1.13 ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;

3.1.14 zhvillimi, mirëmbajtja dhe monitorimi i listës së autorizimeve aktive për akses në transaksionet ose aksionet *online* (duke përfshirë aksesin në bazën e të dhënave të kompanisë OST) duke paraqitur një rrezik shpërndarje të informacionit të ndjeshëm tregtar në pronësi të OST-së;

3.1.15 përgjigjja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST-së në lidhje me Programin e Përputhshmërisë;

3.1.16 udhëzimi i drejtuesve dhe punonjësve të OST-së për Programin e Përputhshmërisë, zbatimin e tij dhe, kur është e përshtatshme, ndryshimet e tij;

3.1.17 koordinim i komunikimit me ERE-n, autoritetet e tjera përkatëse, pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror dhe/ose palë të tjera të treta në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

3.2 Listën e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë, të caktuara në paragrafin 3.1, duhet të konsiderohen si fundore. Çdo shërbim tjetër mund të përfshihet vetëm nëse iu referohet qartë dispozitave të ligjit ose Programit të Përputhshmërisë duke ndryshuar këtë Kontratë.

3.3 Zyrtari i Përputhshmërisë, ndërkohë që ofron shërbimet e tij tek OST-ja, duhet të jetë i lidhur nga detyrimet konfidenciale njësoj si drejtuesit dhe punonjësit e kompanisë OST të vendosura sipas Programit të Përputhshmërisë. Detyrimet konfidenciale duhet të jenë plotësisht të vlefshme gjatë gjithë mandatit të Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe për një periudhë prej 4 (katër) vjetësh pas përfundimit të Kontratës. Mosplotësimi nga Zyrtari i Përputhshmërisë të detyrimeve konfidenciale do të konsiderohet si prishje e kësaj Kontrate.

3.4 Të gjitha rezultatet e shërbimeve të ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë sipas paragrafit 3.1 duhet të paraqiten me shkrim ose me gojë, si kërkohet nga shërbimet përkatëse, derisa të kërkohet një formë specifike nga Zyrtari i Përputhshmërisë sipas Programit të Përputhshmërisë ose kësaj Kontrate.

3.5 Të gjitha dokumentet e përgatitura nga Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jenë në gjuhën shqipe. Raporti vjetor i zhvilluar nga Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përkthehet në gjuhën angleze, pasi duhet të paraqitet në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

4. TË DREJTAT E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

4.1 Për t'u përputhur me detyrimet për ofrimin e shërbimeve për kompaninë OST sipas paragrafit 3.1, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtën për të:⁸

4.1.1 kërkuar kushtet e duhura financiare dhe organizuese që i mundësojnë Zyrtarit të Përputhshmërisë ofrimin e shërbimeve në mënyrë eficiente;

4.1.2 kërkuar bashkëpunim me drejtuesit dhe punonjësit e OST-së kur është e nevojshme për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë;

4.1.3 pasur akses tek të gjitha të dhënat përkatëse dhe në zyrat e OST-së, dhe te informacioni i nevojshëm për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses te zyrat e OST-së pa njoftim paraprak;

4.1.4 pasur akses te të gjitha kontaktet e lidhura nga OST-ja me pjesëmarrësit e tjerë të tregut të gazit natyror, përdoruesit e rrjetit dhe palë të tjera të treta dhe te dokumentet origjinale (ofertat tregtare, deklaratat e pranimit, memorandumet, faturat etj.);

4.1.5 marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve përkatëse të OST-së, përveç atyre që iu jemi referuar në paragrafin 3.1.8, ku Zyrtari i Përputhshmërisë është i detyruar që t'i ndjekë;

4.1.6 marrë pjesë te të gjitha takimet e drejtuesve dhe punonjësve të OST-së, përfshirë takimet funksionale;

4.1.7 siguruar opinionin e tij për dokumentet ose veprimet e brendshme të propozuara nga OST-ja në lidhje me përputhjen e tyre me aktet ligjore në fuqi, përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë, dhe me Programin e Përputhshmërisë.

⁸ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë të përcaktuara në paragrafin 4.1 janë shkruar në përputhje me Draftprogramin e Përputhshmërisë (drafti fillestar i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 7 dhjetor 2016). A duhet që Draftprogrami i Përputhshmërisë të ndryshohet, ju lutem pasqyroni ndryshimet në këtë Draftkontratë.



4.2 Të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë, të cilave nuk iu jemi referuar në paragrafin 4.1, por që vijnë si pasojë e detyrimeve të vendosura të ligji dhe/ose Programi i Përputhshmërisë sipas nevojës për kryerjen siç duhet nga Nëpunësi i Përputhshmërisë dhe ofrimin e shërbimeve që duhet të përmbushen sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

4.3 Palët duhet të sigurojnë përmes bashkëpunimit reciprok që të gjitha të drejtat e Zyrtarit të Përputhshmërisë janë plotësuar siç duhet në përputhje me objektivat e Programit të Përputhshmërisë.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OST-SË

5.1 Anëtarët e [organit/ organeve përgjegjëse] të OST-së dhe Drejtuesit e Përgjithshëm duhet të kenë të drejtën të kërkojnë nga Zyrtari i Përputhshmërisë të ofrojnë shërbimet në kohën e duhur dhe sipas termave dhe kushteve të vendosura në ligj, të Programi Përputhshmërisë dhe kjo Kontratë.

5.2 Organet përgjegjëse të OST-së, të cilave iu jemi referuar në paragrafin 5.1, në çdo kohë mund të kërkojnë nga Zyrtari i Përputhshmërisë të paraqesë shpjegime me shkrim ose raporte për sigurimin e shërbimeve dhe statusin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.

5.3 OST-ja, drejtuesit, punonjësit dhe ose përfaqësuesit e tjerë të autorizuar duhet të kenë të drejtën të paraqesin kërkesat të Zyrtari i Përputhshmërisë në lidhje me aplikimin praktik dhe zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

5.4 OST-ja, drejtuesit, punonjësit dhe/ose përfaqësues të autorizuar duhet të ruhen nga udhëzimet ose kërkesat, ose çdo veprim tjetër që mund të jetë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

5.5 Për të siguruar kushtet e duhura për Zyrtarin e Përputhshmërisë për të kryer detyrat dhe përmbushur të drejtat e tij sipas kësaj kontrate, OST-ja është e detyruar:⁹

5.5.1 t'i ofrojë Zyrtarit të Përputhshmërisë një zyrë të kompletuar me të gjitha pajisjet tek ambientet e OST-së dhe të sigurohet që Zyrtari i Përputhshmërisë ka të gjitha mjetet në zyrë (përfshirë kancelaritë, kompjuterin, pajisjet e

komunikimit etj.), si dhe mbështetjen administrative të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve;

5.5.2 të paguajë për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë si kërkohe në pjesën 6;

5.5.3 të udhëzojë drejtuesit dhe punonjësit për detyrimin për të bashkëpunuar me Zyrtarin e Përputhshmërisë si është e nevojshme për zbatimin e Programit të Përputhshmërisë. Ky detyrim duhet të tregohet qartë të kontratat dhe/ose udhëzimet e drejtuesit/punonjësit të kompanisë OST;

5.5.4 t'i ofrojë Zyrtarit të Përputhshmërisë një akses të pakufizuar tek të gjitha të dhënat, kontaktet dhe të zyrat e OST-së, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer detyrimet e tij;

5.5.5 të mbështesë Zyrtarin e Përputhshmërisë duke ofruar të dhëna, informacion dhe asistencë në kohën e duhur;

5.5.6 të informojë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara ose jo të organeve përkatëse të OST-së, të drejtuesve dhe/ose punonjësve, dhe të ofrojë të gjitha materialet e nevojshme për të marrë pjesë në këto takime. Ky informacion dhe materialet duhet të ofrohen në kohë para takimit;

5.5.7 të përfshijë Zyrtarin e Përputhshmërisë në diskutime të planit dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit, hartimin e akteve të brendshme dhe çështjeve të tjera funksionale, si dhe ndryshimeve strukturore ose ato të korporatës të OST-së;

5.5.8 të informojë Zyrtarin e Përputhshmërisë për ndonjë shkelje të pretenduar të Programit të Përputhshmërisë, konflikt ekzistues ose të mundshëm të interesit të drejtuesve dhe punonjësve të OST-së, shkelje të pretenduar të detyrimeve konfidenciale dhe çdo dukuri tjetër që mund të ketë efekt në zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

5.6 Detyrimet të cilave iu jemi referuar në paragrafin 5.5 duhet të kryhen nga Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë OST ose drejtuesit, ose punonjësit (përkatësisht drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorit) sipas kompetencave dhe mandatit të tyre. Çdo drejtues ose punonjës i OST-së duhet të ketë të drejtën që t'i referohet Zyrtarit të Përputhshmërisë në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë dhe është i detyruar të raportojë çdo shkelje të pretenduar.

⁹ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Ju lutem specifikoni detyrimet e OST-së, a janë ato të nevojshme duke marrë parasysh tekstin përfundimtar të Programit të Përputhshmërisë që do të miratohet nga ERE.



5.7 Të drejtat dhe detyrimet e OST-së, të cilat nuk janë shprehur qartë në pjesën 5, por që rrjedhin nga ligji dhe/ose Programi i Përputhshmërisë sipas nevojës për një performancë në kohë nga Zyrtari i Përputhshmërisë, duhet të plotësohen sipas pëlqimit reciprok midis Palëve.

6. PAGESA PËR SHËRBIMET E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË

6.1 Pagesa për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të bazohet te vlerësimi i performancës nga drejtuesit e OST-së. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të paguhet sipas termave dhe kushteve të Kontratës. Politikat e tjera të pagesës që aplikohen nga OST-ja nuk duhet të kenë efekt te pagesa për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

6.2 Pagesa mujore për shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të jetë [●] lekë.

6.3 Pagesa referuar në paragrafin 6.2 duhet të jetë pa taksat dhe zbritje të tjera. Nëse kërkohet që ato të vendosen sipas akteve ligjore në fuqi, tatimet, taksat dhe zbritjet, përfshirë ato që kanë lidhje me punësimin, duhet të kompensohen të ndara nga OST-ja.¹⁰

6.4 Të gjitha kostot e shkaktuara nga OST-ja për shkak të kryerjes së detyrimeve të tij sipas pjesës 5 do të përballohen nga OST-ja dhe nuk do të kenë efekt te paga për shërbimet e ofruara nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

6.5 Të gjitha pagesat e Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të kryhen çdo muaj jo më vonë se data 10 (dhjetë) e çdo muaji. Në rast se pagesa vonohet, OST-ja është e detyruar të paguajë një kamatëvonesë, e cila është e barabartë me [0.02%] të pagesës së vonuar.

7. DETYRIMET FINANCIARE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

7.1 Palët janë të detyruara për zbatimin siç duhet të Kontratës sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligj dhe për më tepër te Programi i Përputhshmërisë.

7.2 Në rast prishje të Kontratës, secila Palë mund të ankohet për humbjet direkte, të cilat duhet të kompensohen nga Pala fajtoare. Këto humbje duhet të llogariten dhe arsyetohen sipas termave dhe kushteve të vendosura në aktet ligjore në fuqi.

7.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo Kontratë ose ato që kanë lidhje me zbatimin e saj duhet të zgjidhen në mënyrë shoqërore duke ndjekur konsultimet reciproke nga Palët.

7.4 Në rast se palët nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen sipas paragrafit 7.3, secila Palë ka të drejtën që të drejtohet në ERE për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, bazuar në vendimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ose mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

7.5 Të dyja Palët bien dakord që, për qëllim të kësaj Kontrate, duhet të përjashtohet gjykimi tregtar si formë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

8. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

8.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo miratohet nga ERE, si specifikohet edhe këtu. Mandati i Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të fillojë ditën tjetër të punës pas miratimit që i jemi referuar më sipër.

8.2 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data kur është miratuar nga ERE.

8.3 Të gjitha ndryshimet e Kontratës duhet të bëhen sipas marrëveshjes reciproke mes Palëve, *ndër të tjera* duke marrë parasysh ndryshimet ligjore. Çdo ndryshim në këtë Kontratë, në çdo kohë që ajo të hyjë në fuqi, duhet t'i nënshtrohet miratimit nga ERE.

8.4 Kjo Kontratë mund të përfundojë para kohë, si specifikohet në paragrafin 8.2, vetëm në rastet e mëposhtme:

8.4.1 Me kërkesën e Zyrtarit të Përputhshmërisë, e cila ndiqet nga njoftimi me shkrim i Drejtorit të Përgjithshëm të OST-së të paktën 2 (dy) muaj para datës së njoftuar për mbarimin e saj;

8.4.2 Me iniciativën e OST-së, në rast se Zyrtari i Përputhshmërisë nuk plotëson kushtet e kualifikimit dhe/ose pavarësinë, si është vendosur në ligj, te Programi i Përputhshmërisë dhe tek kjo Kontratë; ose

8.4.3 Bazuar në marrëveshjen reciproke midis Palëve.

8.5 Në rastin e marrëdhënieve të punësimit midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, asnjë nga kushtet e lejuara nga Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë nuk mund të aplikohet për përjashtimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë përveç

¹⁰ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Ju lutem specifikoni taksat ose detyrimet që kanë lidhje, nëse është e nevojshme.



pikave të përmendura në paragrafin 8.4.¹¹

8.6 Para mbarimit të mandatit, qoftë kjo për shkak të mbarimit të vlefshmërisë së Kontratës ose mbylljes së parakohshme në përputhje me paragrafin 8.4, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë listën e dokumenteve në zotërim të tij, arsyetimet e nevojshme me shkrim dhe raportin përfundimtar të aktiviteteve të tij, të cilat do t'i dorëzohen Drejtorit të Përgjithshëm të kompanisë OST.

8.7 Vendimi për përfundimin e kësaj Kontrate dhe, si pasojë, shkarkimi i Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të merret nga [organi përkatës] i OST-së, duke shpjeguar qartë arsyet për përfundimin e Kontratës dhe vendimi duhet të miratohet nga ERE.

9. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

9.1 Kjo Kontratë duhet të drejtohet, ndërtohet, interpretohet dhe të zbatohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

9.2 Kontrata është bërë në gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje njësoj kufizuese, nga një kopje për secilën prej Palëve dhe një kopje duhet të paraqitet në ERE.

9.3 Shtojcat më poshtë duhet t'i bashkëlidhen Kontratës:

9.3.1 Shtojca I. Programi i Përputhshmërisë;

9.3.2 Shtojca II. Kriteret profesionale dhe kriteret përzgjedhëse të Zyrtarit të Përputhshmërisë.

9.4 Me hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet t'i ofrojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë një kopje të Kontratës dhe shtojcave të saj në gjuhën angleze.

10. KUSHTET E DOMOSDOSHME (REKUIZITAT) DHE NËNSHKRIMI NGA PALËT

10.1 Të gjitha komunikimet mes palëve duhet të përpunohen bazuar te kontaktet e mëposhtme dhe te kushtet e domosdoshme (rekuizitat):

OST

[adresa]

[numri i telefonit, faksit dhe adresa e email-it]

Zyrtari i Përputhshmërisë

[adresa]

[numri i telefonit, faksit, adresa e email-it]

[llogaria bankare dhe detajet e bankës]

Në emër të kompanisë OST: Në emër të Zyrtarit të Përputhshmërisë:

VENDIM

Nr. 79, datë 26.5.2017

PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 31.3.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

¹¹ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë: Kjo dispozitë, duke iu referuar marrëdhënieve të mundshme të punësimit midis OST-së dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, mund të hiqet në rast mbyllje të kësaj Kontrate me një person juridik, i cili ofron shërbimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë.



- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 80, datë 26.5.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe 39 pika 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 4, pika 1, germa “d”; neni 5, pika 1, germa “d”, neni 13; të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të

energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 18.4.2017, vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1” dhe “c1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 (pesë) - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë